



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 42, datë 11.02.2021

MBI

HEQJEN E LICENCËS NR. 407, SERIA P18K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “MALSIA SOLAR 3” SH.P.K. ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 107, DATË 30.04.2018.

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, pika 1, gërma “ç”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 7, 8 dhe 9, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; pikës 6.1, gërma “ç”, të Kushteve të Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 11.02.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 25/1 prot., datë 05.02.2021, të përgatitur nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin nr. 125, datë 04.11.2020 të Kryetarit të ERE, mbi heqjen e licencave të subjekteve debitoare ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit,

Konstatoi se:

- Shoqëria “MALSIA SOLAR 3” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 407, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 107, datë 30.04.2018, për një afat 25-vjeçar.
- Shoqërisë “MALSIA SOLAR 3” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/15 Prot, datë 04.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të “Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave”, me Urdhrin nr. 125, datë 04.11.2020, të Kryetarit të ERE ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së Rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t’i shërbente hetimit administrativ të filluar me Urdhrin sipërcituar.
- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti “MALSIA SOLAR 3” sh.p.k., nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 229, datë 15.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 407, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë

shoqërisë “MALSIA SOLAR 3” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 107, datë 30.04.2018.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim me shkresën e ERE-s nr. 1172/15-1 prot., datë 23.12.2020 dhe i është bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.
- Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë apo për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës.
- Në nenin 42, pika 1, gërma “ç”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikohet se *ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.*
- Në pikën 6.1, gërma “ç”, të Kushteve të Licencës së Prodhimit të Energjisë Elektrike parashikohet se *ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.*
- Në nenin 5, gërma “ç”, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.58, datë 18.04.2017, parashikohet:
ERE heq një licencë kur i licencuari:
ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit të energjisë elektrike ose nenin 14, të ligjit për gazin natyror.
- Në nenin 9, gërma “c”, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, parashikohet se:
Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:
c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat "a", "b", "c", "ç" dhe / ose "d", të nenit 5, të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.
- Me heqjen e licencës nr. 407, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 107, datë 30.04.2018, shoqëria “MALSIA SOLAR 3” sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të heqë licencën nr. 407, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “MALSIA SOLAR 3” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 107, datë 30.04.2018.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i Punës të njoftojë të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “MALSIA SOLAR 3” sh.p.k. dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI